



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008 dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

th ë r r e t

mbledhjen e **nëntë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **21.12.2016**, dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS :

1. **Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;**
2. **Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;**
3. **Propozimvendimi për rikatëgorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur;**
4. **Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017;**
5. **Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për Komitetin për komunitete;**
6. **Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike;**
7. **Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015 / 2016;**
8. **Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet: B17, B18, B19 dhe B 20, të lagjes" Mati 1;**
9. **Caktimi i një anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë;**
10. **Pyetje dhe përgjigje;**
11. **Të ndryshme.**

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 006-302553, më 13.12.2016

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>